



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.162

16 dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7167 datë 30.11.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8201
Akt normativ i KM nr.4, datë 14.12.2011	Për një ndryshim në ligjin nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar	8201
Vendim i KM nr.767, datë 2.11.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.652, datë 14. 9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011 - 2012”	8202
Vendim i KM nr.803, datë 23.11.2011	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për degën e doganës Kapshticë dhe degën e doganës Korçë, si autoritete kontraktore....	8203
Vendim i KM nr.804, datë 24.11.2011	Për lejimin e realizimit të procedurave dhe shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit e të njoftimit të kontratës së lidhur për disa prokurime të qendrës spitalore universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, si autoritet kontraktor.....	8204
Vendim i KM nr.805, datë 24.11.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z.Rezar Veseli.....	8205
Vendim i KM nr.806, datë 16.11.2011	Për një shtesë në vendimin nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar.....	8206

Vendim i KM nr.809, datë 23.11.2011	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe drejtorive rajonale rrugore në qarqe, si autoritete kontraktore, për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave për rastet e situatave emergjente dimërore.....	8206
Vendim i KM nr.810, datë 23.11.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.208, datë 24.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie ndihme financiare Qeverisë së Kosovës për realizimin e projekteve të propozuara për komunën Graçanicë, Kosovë”, të ndryshuar.....	8208
Vendim i KM nr.811, datë 23.11.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Ilirian Agaraj.....	8208
Vendim i KM nr.812, datë 10.11.2011	Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit.....	8209
Vendim i KM nr.813, datë 23.11.2011	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2012.....	8210
Vendim i KM nr.815, datë 23.11.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	8211
Vendim i KM nr.816, datë 16.11.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.542, datë 27.7.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”.....	8212
Vendim i KM nr.848, datë 6.12.2011	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të shoqërive “Telemenia Alb”, sh.a., dhe “F.K. Generators Equipment”, ltd e “Melta Inter Industries”, ltd, për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Curraj.....	8216
Udhëzim i KM nr.4, datë 23.11.2011	Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011.....	8217

DEKRET
Nr.7167, datë 30.11.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Gent Shpend Bajrami

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

AKT NORMATIV
Nr.4, datë 14.12.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.10 355, DATË 2.12.2010 “PËR BUXHETIN E VITIT 2011”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Neni 18 i ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitit 2011, është 84 690 milionë lekë, i detajuar, si më poshtë vijon:

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 29 312 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 45 800 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 6 926 milionë lekë.
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja, të papaguara, deri në 2 652 milionë lekë.”.



Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.767, datë 2.11.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.652, DATË 14.9.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE, “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, PËR VITIN AKADEMIK 2011 - 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin 2011 - 2012, të jenë 6966. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve të bukura” | 6676; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi | 100; |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) Kuota për shtetas të huaj | 50; |
| d) Kuotat për personat që nuk shikojnë | 20; |
| dh) Kuotat për romët /ballkano-egjiptianët | 20.”. |

2. Shkronja “a” e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për aplikantët brenda territorit të vendit, 6645”.

II. Në fund të tabelës nr.1, që i bashkëlidhej vendimit, shtohen programet e studimit sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca nr.1
KUOTAT DHE TARIFAT CIKËL II, MASTER I SHKENCAVE
VITI AKADEMIK 2011-2012

A	B	C	D	E	F	G
K_Universiteti	K_ID_Program	K_Emërtimi_Program	Kuota prog. Student shqiptar	Kuota nga trojet	Tarifa për kredit (në lekë)	Tarifa totale 120 kredite (në lekë)
Universiteti i Tiranës	177	Shërbime sociale në drejtësinë penale	30	0	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	178	Administrim i çështjeve sociale	30	0	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	179	Studime rajonale politike	50	0	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	180	Çështje të fëmijëve dhe të familjeve	30	0	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	181	Komunikimi për ndryshim social dhe të sjelljes	30	0	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	182	Psikologji organizacional	40	0	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	183	Psikolog shkollor	40	0	1,250	150,000
Universiteti i Tiranës	184	Psikolog klinik	40	0	1,250	150,000

VENDIM
Nr.803, datë 23.11.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, PËR DEGËN E DOGANËS KAPSHTICË DHE DEGËN E DOGANËS KORÇË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, degës së doganës Kapshticë dhe degës së doganës Korçë, si autoritete kontraktore, të përfundojnë procedurat e prokurimit për mallra e ndërtime me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2011, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 15 dhjetor 2011.



Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe autoritetet në varësi të saj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

1. “Blerje licenca oracle dhe support” me fond limit 7 316 667 (shtatë milionë e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. “Skanera për kontroll bagazhesh” 13 736 667 (trembëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

3. “Sistem vëzhgim-survejim me kamera në degët doganore” me fond limit 5 916 173 (pesë milionë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Dega e doganës Kapshticë

1. Ndërtim pusi dhe furnizim me ujë, me fond 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë me TVSH.

Dega e doganës Korçë

1. Ndërtim pusi dhe furnizim me ujë, me fond 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

VENDIM

Nr.804, datë 24.11.2011

PËR LEJIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURAVE DHE SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR DISA PROKURIME TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në vijim të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, si autoritet kontraktor, të realizojë, brenda datës 10.12.2011, procedurat e prokurimit, si më poshtë vijon:

a) “Blerje materialesh mjekësore për hemodializën”, me fond limit 47 000 000 (dyzet e shtatë milionë) lekë, me TVSH.

b) “Blerje barnash të ndryshme për shërbimet mjekësore”, me fond limit 67 000 000 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë) lekë, me TVSH;

c) “Blerje suturash qepëse (penj), për nevojat e shërbimeve të kirurgjisë”, me fond limit 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekë, me TVSH;

ç) “Blerje kitesh dhe reagentësh për laboratorët”, me fond limit 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, me TVSH;

d) “Blerje filmash dhe kontrastesh për shërbimin e radiologjisë”, me fond limit 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, me TVSH;

dh) “Blerje gazoili dhe solari për nevojat e ngrohjes së shërbimeve në spital”, me fond limit 65 976 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, me TVSH.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Përjashtimisht, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, lejohet t’i përdorë fondet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar në po këtë pikë.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.805, datë 24.11.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z.REZAR VESELI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z. Rezar Veseli.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.806, datë 16.11.2011

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 pika 3 e 75 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht për vitin 2011, lejohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) të realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve elektronike e të materialeve për zyra, për investime për rikonstruksionin e zyrave të sporteve, të sistemit elektronik të integruar, të materialeve promovuese dhe të logos. Procedurat e prokurimit, përfshirë lidhjen e kontratave përkatëse dhe botimin e njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike, të përfundojnë brenda datës 10.12.2011.”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.809, datë 23.11.2011

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE DHE DREJTORIVE
RAJONALE RRUGORE NË QARQE, SI AUTORITETE KONTRAKTORE, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE LIDHJEN E KONTRATAVE PËR
RASTET E SITUATAVE EMERGJENTE DIMËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe drejtorive rajonale rrugore në qarqe, si autoritete kontraktore, për kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e përcaktuara sipas

listave 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, dhe të procedurave të prokurimit e lidhjen e kontratave për rastet e situatave emergjente dimërore, të paparashikuara në buxhetin e miratuar, zëri “Emergjencia”, brenda vitit 2011.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, drejtoritë rajonale rrugore në qarqe, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lista nr.1

Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve

1. Ndërtim rruga by pass perëndimor Shkodër, loti 1.
2. Ndërtim rruga by pass perëndimor Shkodër, loti 2;
3. Supervizion punimesh ndërtim rruga by pass perëndimor Shkodër, loti 1;
4. Supervizion punimesh ndërtim rruga by pass perëndimor Shkodër, loti 2;
5. Menaxhimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i tunelit të Thirrës, të autostradës Rrëshen-Kalimash (shtesë kontrate);
6. Mirëmbajtje me performancë dhe dimërore për aksin rrugor Milot-Reps;
7. Mirëmbajtje me performancë dhe dimërore për aksin rrugor Reps-Kalimash;
8. Supervizion i mirëmbajtjes rutinë dhe dimërore me bazë performancë segmenti rrugor Milot-Reps-Kalimash.
9. Ndërtim rruga Kukës-Morinë, loti 1 (vepra arti të mëdha), dublimi (shtesë kontrate);
10. Ndërtim rruga Qukës-Qafë Plloçë, loti 1 (vepra arti të mëdha), dublimi (shtesë kontrate);

Lista nr.2

Autoriteti kontraktor: drejtoritë rajonale rrugore në qarqe

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi limit 000/lekë	Financimi v.2011 000/lekë	financimi	kontraktori
1	L.T.M+FV kabinë elektrike, aksi rrugor Përroi i Agait-Rrogozhinë	26,400	7,920	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Tiranë
2	Mbrojtja e urës së Devollit (Gostimë) km 75.500 Segmenti rrugor K/Gostimë-Mollas	9,477	9,477	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Elbasan
3	Riparim segmenti rrugor km 13.7 lokali i Mëhillit, km 23.3, Baz, km 26.2 Komuna Baz, km 29.1 afër urës së Karicës	2,979	2,979	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Dibër
4	Riparim fuga superstrada Lezhë-Milot	3,000	3,000	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Lezhë
5	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga nacionale Elbasan-Kaçolite (Kërrabë)	2,226	742	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Elbasan
6	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga nacionale Xibrakë-Qafë Thanë	10,084	3,361	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Elbasan
7	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga Librazhd-Steblevë	6,129	2,043	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Elbasan
8	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore aksi rrugor Jorgucat-Qafë Muzinë	1,044	348	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Gjirokastër



9	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga nacionale Korçë-Qafë Qarri-Ersekë-Leskovik	12,168	4,056	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Korçë
10	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga nacionale Boboshticë-Dardhë + Korçë-Voskopojë + Libonik-Lozhan-Grabovë	12,428	4,143	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Korçë
11	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga Tiranë-K/Dajt-Kamp + K/Dajt-Bizë + K/Dajt-Antena	8,103	2,701	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Tiranë
12	Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore rruga Orikum-Borsh + Sarandë-Muzinë	8,139	2,713	Buxheti i Shtetit	Drejtoria Rajonale Rrugore, Vlorë

VENDIM
Nr.810, datë 23.11.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.208, DATË 24.3.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË KOSOVËS PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PROPOZUARA PËR KOMUNËN GRAÇANICË, KOSOVË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.208, datë 24.3.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit që në bashkëpunim me komunën Graçanicë, të përcaktojë projektet që do të financohen me ndihmën financiare të sipërpërmendur. FSHZH-ja ngarkohet, gjithashtu, me ndjekjen e realizimit të këtyre projekteve, në përputhje me një marrëveshje që do të lidhet ndërmjet palës përfituese dhe asaj zbatuese.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.811, datë 23.11.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. ILIRIAN AGARAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Ilirian Agaraj.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.812, datë 10.11.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROVIMIN E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 dhe 13, shkronja “c” të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit, si më poshtë vijon:
 - a) Për kandidatin që jep provimin për herë të parë 10 000 lekë;
 - b) Për kandidatin që jep provimin për herë të dytë 12 500 lekë;
 - c) Për kandidatin që jep provimin për herë të tretë 15 000 lekë;
 - ç) Për kandidatin që jep provimin për herë të katërt 17 500 lekë;
 - d) Për kandidatin që jep provimin për herë të pestë 20 000 lekë.
 2. Tarifat për provimin e shtetit, të llogaritura sipas pikës 1 të këtij vendimi, arkëtohen para procesit të regjistrimit për provim, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të Postës Shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Kombëtare të Provimeve.
 3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa për provimin e shtetit nga Agjencia Kombëtare e Provimeve derdhen 100% në buxhetin e Agjencisë.
 4. Pjesa e të ardhurave që i takon Agjencisë Kombëtare të Provimeve evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 05, “Të ardhurat e veta”.
 5. Të ardhurat që sigurohen nga këto tarifa menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe përdoren si më poshtë:
 - a) për pagesën e anëtarëve të grupeve të hartimit të fondit të pyetjeve dhe të Komisionit të Provimit të Shtetit;
 - b) për të mbuluar shpenzimet për organizimin dhe funksionimin e provimit të shtetit.
 6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.813, datë 23.11.2011

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIO DHE TELEVISIONIT, PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), për vitin 2012, në shumën 98 400 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë e katërqind mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIO DHE TELEVISIONIT

Pasqyra nr.1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2012

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	
1	Paga dhe sigurime shoqërore	55.6
2	Honorare	2.0
3	Materiale e shërbime	5.0
4	Shërbime nga të tretët e transport	7.0
5	Shërbime udhëtimi, dieta e kuota	5.0
6	Shpenzime për mirëmbajtjen	0.5
7	Shpenzime të tjera	1.5
8	Detyrime për vendimet gjyqësore	20.5
9	Investime	1.3
	Shpenzime gjithsej	98.4

VENDIM
Nr.815, datë 23.11.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT
RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Neni 71/1, “Auditimi i sigurisë rrugore”, i rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 71/1

Auditimi i sigurisë rrugore (Neni 35 i Kodit Rrugor)

1. Auditimi i sigurisë rrugore nënkupton kontrollin e pavarur dhe sistematik të projektit për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve, si dhe të projekteve të sinjalizimit rrugor apo instalimeve të tjera të trafikut, për të zbuluar e parandaluar gabimet në projektim ose zbatim, të cilat përbëjnë rrezik për ndodhjen e aksidenteve rrugore. Auditimi është mbështetje për entin pronar të rrugës, personin përgjegjës të projektit, si dhe atë zbatues të punimeve. Auditimi është i detyrueshëm për çdo projekt për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve apo instalimeve të tjera të trafikut nga pikëpamja e sigurisë rrugore dhe kryhet sipas metodave standarde, të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon veprimtarinë e transportit dhe të ministrit që mbulon veprimtarinë e pushtetit vendor.

2. Auditimi i sigurisë rrugore kryhet nga subjekte juridike. Personat e certifikuar si auditues, përfaqësues të këtyre subjekteve, duhet të kenë përvojë pune mbi 5 (pesë) vjet në fushën e sigurisë rrugore. Auditimi i sigurisë rrugore kryhet, së paku, nga dy auditues.

3. Subjekti, që kryen auditimin e sigurisë rrugore, caktohet në përputhje me legjislacionin e prokurimit të fondeve publike.

4. Rregullat, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për përzgjedhjen e personave, të cilët do të kryejnë auditimin/inspektimin e sigurisë rrugore, si dhe veprimtaria e tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon veprimtarinë e transportit dhe të ministrit që mbulon veprimtarinë e pushtetit vendor.

5. Auditimi i sigurisë rrugore duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të hartimit të projekteve të infrastrukturës dhe kryhet në fazat e projektidesë, të projektit të zbatimit dhe gjatë të gjithë periudhës së ndërtimit dhe asaj të kolaudimit. Në rrugët ekzistuese, kryhet inspektimi i sigurisë rrugore.

6. Subjekti juridik i auditimit të sigurisë rrugore paraqet një raport me shkrim për çdo fazë të projektit të infrastrukturës, ku trajton edhe ndryshimet në projekt/ose në rrugë, që ai rekomandon, si dhe arsyet. Ky raport u dërgohet subjektit projektues, entit pronar të rrugës dhe njësisë së monitorimit e kontrollit të procesit të auditimit në ministrinë që mbulon veprimtarinë e transportit.

7. Subjekti projektues është i detyruar të marrë në konsideratë raportin e auditimit të sigurisë rrugore dhe të reflektojë për përmbajtjen e tij duke përpiluar me shkrim arsyet e pranimit



ose jo të raportit apo duke dhënë një zgjidhje tjetër nga ajo e propozuar dhe u dorëzon nga një kopje entit pronar të rrugës, njësisë së monitorimit e kontrollit të procesit të auditimit në ministrinë që mbulon veprimtarinë e transportit dhe vetë subjektit juridik që ka kryer auditimin.

8. Në rastin e inspektimit të sigurisë rrugore në rrugët ekzistuese, grupi i inspektimit i dorëzon entit pronar të rrugës, së cilës i bëhet ky inspektim, një raport, me shkrim, ku parashtron të gjitha problemet e vëna re dhe propozimet për zgjidhjen e tyre.

9. Raportet e audituesve/inspektuesve dhe deklaratat, e përmendura në pikën 7 të këtij vendimi, i bashkëlidhen dokumentacionit të projektit.

10. Për kryerjen e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore, për t'u orientuar gjatë lidhjes së kontratave, tarifat do të jenë, si më poshtë vijon:

a) Tarifa për kryerjen e auditimit të sigurisë rrugore për projektet për ndërtimin, për rehabilitimin dhe/ose modernizimin e rrugëve, do të ketë një vlerë deri 0,3 % nga vlera e përgjithshme e investimit.

b) Për inspektimin e sigurisë rrugore në rrugët ekzistuese të hapura për trafikun, tarifa do të jetë një çështje e marrëveshjes kontraktuale, ndërmjet enteve pronare të rrugëve e inspektorëve dhe do të ketë një vlerë deri në 1% të vlerës së përgjithshme të investimit.”.

2. Ngarkohen entet pronare të rrugëve dhe institucionet përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi, si dhe për planifikimin e fondeve të nevojshme, mbështetur në buxhetin e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.816, datë 16.11.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.542, DATË 27.7.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 4, të nenit 27 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror, që i bashkëlidhet vendimit nr.542, datë 27.7.2005 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Administrimit të Shërbimeve Shoqërore për individët në nivel kombëtar;”.

b) Në fillim të shkronjës “e”, pas fjalës “Kontrollit...” shtohet shprehja “...të zbatimit të legjislacionit dhe...”.

c) Pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “f” dhe “g”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“f. Administrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror;

g) Monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale në nivel kombëtar”.

2. Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d. Organizon dhe drejton procesin e monitorimit të përdorimit të fondeve të buxhetit për shërbimet shoqërore që administrojnë;”.

b) Shkronja “f” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“f. Vlerëson nevojat për shërbime të reja për subjektet përfituese të shërbimeve shoqërore, sipas nenit 13 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe i propozon për miratim Këshillit Administrativ ngritjen ose mbylljen e tyre në nivel kombëtar.”.

c) Shkronjat “g” dhe “h” shfuqizohen.

ç) Shkronjat “k” dhe “l” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“k. Ofrimin e shërbimit rezidencial në nivel kombëtar për individët në nevojë dhe deinstitutionalizimin e shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror që administrojnë;

1. Kryen komisionimin për pranimin e personave, subjekte përfituese të shërbimeve shoqërore, sipas nenit 13 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të cilët duhet të vendosen në institucionet në nivel kombëtar për shërbimin rezidencial, si dhe për shërbimet e deinstitutionalizuara.”.

d) Pas shkronjës “n” shtohet shkronja “o”, me këtë përmbajtje:

“o. Marrjen e vendimit për sistemin në shërbimin e përkujdesit shoqëror, pas verifikimit në regjistrin elektronik për të dhënat e hedhura nga administratorët për individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, ku këta të fundit nuk ofrohen nga njësi vendore.”.

3. Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “c” shprehja “...në nivel dymujor...” shfuqizohet.

b) Shkronja “d” shfuqizohet.

c) Në shkronjën “e” shprehja “...inspektimit të...” shfuqizohet.

4. Në shkronjën “d” të nenit 5, shprehja “...inspektimit të...” shfuqizohet.

5. Në fund të shkronjës “d” të nenit 6, shtohet shprehja “...dhe në institucionet e përkujdesit shoqëror në nivel kombëtar.”.

6. Në nenin 10 fjalia e fundit shfuqizohet.

7. Në nenin 14 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c. Propozon te ministri strukturën e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal, si dhe të institucioneve të përkujdesit shoqëror që administrojnë, i cili, sipas procedurave ligjore, e përcjell për miratim.”.

b) Pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “i” dhe “j”, si më poshtë vijon:

“i. Miraton rregulloret e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror.

“j. Miraton hapjen/mbylljen e shërbimeve të përkujdesit në nivel kombëtar.”.

8. Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

d. Miraton rregulloret e organizimit dhe funksionimit të administratës së Shërbimit Social Shtetëror në nivel rajonal dhe të institucioneve të përkujdesit shoqëror në nivel kombëtar.”.

b) Shkronja “f” shfuqizohet.

c) Shkronja “g” shfuqizohet.

9. Pas nenit 16 shtohen nenet 17, 18 dhe 19, si më poshtë vijon:

“Neni 17

Rekrutimi i punonjësve

1. Punonjësit e Shërbimit Social Shtetëror emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm.



2. Përzgjedhja e nëpunësve i nënshtrohet procedurave të konkurrimit të hapur.
3. Drejtori i Përgjithshëm urdhëron shpalljen e vendit të lirë në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në faqen e internetit të SHSSH-së dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së konkurrimit.
4. Kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithshme për t'u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i SHSSH-së.
5. Procedura e testimit miratohet me akt administrativ të drejtorit të përgjithshëm të SHSSH-së.
6. Drejtori i Përgjithshëm përzgjedh njërin nga dy kandidatët fitues.
7. Për emërimin dhe lirin e drejtuesve në drejtorinë e përgjithshme, në strukturat rajonale e vendore, si dhe të përkujdesit shoqëror që administron, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror merr miratimin paraprak të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili duhet të shprehet brenda 10 (dhjetë) ditëve.
8. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit i paraqiten komisionit të ngritur nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga botimi i rezultateve të konkurrimit në dy gazetat me qarkullim më të madh.
9. Komisioni zgjidh ankesën, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e regjistrimit të ankesës, dhe vendos për:
 - a) rrëzimin e ankesës, kur nuk vëren parregullsi dhe shkelje procedurale në zhvillimin e konkurrimit;
 - b) pranimin e ankesës kur vëren parregullsi në zhvillimin e konkurrimit;
 - c) anulimin e konkurrimit, kur vëren shkelje procedurale në zhvillimin e tij.
10. Për rastet e parashikuara në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 9 të këtij neni, procedura e konkurrimit përsëritet, duke filluar nga faza ku ka pasur parregullsi procedurale.
11. Vendimi i komisionit i njoftohet të interesuarit brenda 4 (katër) ditëve nga data e marrjes së vendimit.
12. Personi i interesuar mund të ankohet në gjykatën e shkallës së parë:
 - a) ndaj vendimit të komisionit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit;
 - b) brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e mbarimit të afatit për zgjidhjen e ankesës nga komisioni.
13. Marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të SHSSH-së, fillojnë me aktin e emërimit, i cili nënshkruhet nga drejtori i Përgjithshëm, pas përfundimit të procedurës së ankimimit, sipas pikave 9 e 10 të këtij neni.
14. Punonjësit e SHSSH-së, në momentin e punësimit të tyre, mund t'i nënshtrohen një periudhe prove, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, për të provuar aftësitë e tyre për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës.
15. Marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të SHSSH-së pas përfundimit të periudhës së provës, janë pa afat.
16. Procedurat e lirit për të gjithë punonjësit e SHSSH-së rregullohet në përputhje me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 18

Masat disiplinore

1. Për mosplotësimin e detyrave, thyerjen e disiplinës në punë e të rregullave të etikës, si dhe për raste të tjera, të parashikuara në rregulloren e brendshme të SHSSH-së.

- a) Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së i jepet masë disiplinore nga ministri;
- b) Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së u jep masë disiplinore punonjësve të tjerë të SHSSH-së. Për drejtuesit në drejtorinë e Përgjithshme, në strukturat rajonale e vendore, si dhe ato të përkujdesit shoqëror që administrojnë, merr miratimin paraprak nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili duhet të shprehet brenda 10 (dhjetë) ditëve.
2. Masa disiplinore propozohet nga eprori direkt i punonjësit dhe jepet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, duke garantuar të drejtën për t'u informuar, dëgjuar, mbrojtur dhe ankuar.
3. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore, por nuk është e nevojshme të jepen të gjitha masat disiplinore, përpara masës së largimit nga puna.
4. Llojet e masave disiplinore janë:
 - a) Vërejtje me shkrim;
 - b) Vërejtje me paralajmërim;
 - c) Pezullim nga e drejta për të konkurruar për ngritje në detyrë;
 - ç) Largim nga puna.
5. Masat disiplinore mund të shlyhen, nëse nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, brenda:
 - a) 1 (një) viti, nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" e "b" të pikës 4 të këtij neni;
 - b) 3 (tre) vjetësh, nga data e dhënies së tyre, për shkronjën "c" të pikës 4 të këtij neni.Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake e punonjësit.
6. Ankesat ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore paraqiten në komisionin e ngritur nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e komunikimit të vendimit. Drejtori i Përgjithshëm ankimohet pranë Kryeministrit.

Neni 19

Marrëdhëniet e Shërbimit Social Shtetëror me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

1. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ushtron kontroll në veprimtarinë e Shërbimit Social Shtetëror.
2. Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së raporton në strukturën politikëbërëse për çështjet e ndihmës ekonomike dhe shërbimet sociale për:
 - a) statusin, ecurinë e zbatimit të buxhetit, bilancin financiar, efikasitetin, rezultatet e veprimtarisë së këtij institucioni dhe programet e zbatuara apo që janë në vazhdim;
 - b) mbledhjen dhe përpunimin e evidencave statistikore për nivelin qendror, rajonal dhe atë vendor;
 - c) propozimet për përmirësime dhe ndryshime në legjislacion, si dhe për çdo nismë për rregullore organizative dhe funksionimi, në nivel qendror e vendor, projekte, studime e bashkëpunime në fushën e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve sociale.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror paraqet në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, propozimet për projektbuxhetin.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror paraqet brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, te Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, raportin vjetor të SHSSH-së, i cili duhet të përmbajë:
 - a) veprimtarinë vjetore të SHSSH-së për detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;



- b) personelin e SHSSH-së;
- c) statistikat e përpunuara gjatë vitit për situatën e zbatimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore;
- ç) të dhëna të tjera, që lidhen me aspektet e zbatimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, të cilat gjykohen të nevojshme nga Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.848, datë 6.12.2011

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “TELEMENIA ALB”, SHA DHE “F.K. GENERATORS EQUIPMENT”, LTD E “MELTA INTER INDUSTRIES”, L.T.D., PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE MBI LUMIN CURRAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të shoqërive “Telemenia Alb”, sh.a., dhe “F.K. Generators Equipment”, l.t.d. e “Melta Inter Industries”, l.t.d., për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Curraj, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.4, datë 23.11.2011

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2011, të jetë 36 526 (tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2011, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2, nr.3, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Për qytetet për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e koston mesatare të ndërtimit, të merren vlerat e koston së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t’iu referuar zonave të afërta.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1
KOSTO MESATARE E NDËRTIMIT

Në koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. rrjetit inxhinierik,
2. projektit,
3. studimit gjeologjik dhe sizmik,
4. lejes së ndërtimit,
5. truallit,
6. shpenzime operacionale të EKB 4%.

Nr.	Qyteti	Kosto mesatare (aritmetike)	
		Lekë/m ² sip. shfrytëzimi	Lekë/m ² sip.ndërtimi
1	Berat	36,133	29,671
2	Dibër	36,959	30,347
3	Durrës	36,188	29,714
4	Elbasan	35,730	29,334
5	Ersekë	36,645	30,094
6	Fier	36,103	29,645
7	Gramsh	35,884	29,461
8	Gjirokastër	36,951	30,347
9	Korçë	36,450	29,934
10	Krujë	36,641	30,090
11	Kavajë	36,188	29,714



12	Kuçovë	36,070	29,619
13	Kukës	37,151	30,510
14	Laç	36,532	29,999
15	Lezhë	36,760	30,187
16	Librazhd	36,317	29,820
17	Lushnjë	35,915	29,492
18	Mat	36,956	30,347
19	Përrenjas	36,248	29,763
20	Peqin	35,834	29,420
21	Përmet	36,838	30,252
22	Pogradec	36,645	30,094
23	Pukë	37,289	30,628
24	Rrëshen	36,659	30,104
25	Skrapar	36,276	29,789
26	Sarandë	36,904	30,306
27	Shkodër	36,745	30,176
28	Tepelenë	36,838	30,252
29	Tropojë	37,330	30,661
30	Tiranë	36,427	29,910
31	Vlorë	36,712	30,147
	Kosto mesatare	36,526	29,994

TABELA NR.2
VLERAT MESATARE TË SHITBLERJEVE NË TREGUN E LIRË
PËR VITIN 2011 SIPAS QYTETEVE

Nr.	Qytetet	Lekë/m ² , sipërfaqe shfrytëzimi
1. Qarku Berat		
1	Berat	39,350
2	Çorovodë	18,150
3	Kuçovë	33,400
4	Polican	22,230
5	Ura Vajgurore	31,060
2. Qarku Dibër		
6	Burrel	42,389
7	Bulqizë	41,100
8	Peshkopi	46,472
9	Klos	35,000
3. Qarku Durrës		
10	Durrës	74,540
11	Krujë	49,720
12	Fushë-Krujë	50,180
13	Shijak	43,615
14	Sukth	41,000
4. Qarku Elbasan		
15	Belsh	34,300
16	Cërrik	39,047
17	Elbasan	49,120
18	Gramsh	39,200
19	Librazhd	44,025
20	Peqin	39,824
21	Përrenjas	41,100
5. Qarku Fier		
22	Ballsh	30,100

23	Divjakë	44,000
24	Fier	58,500
25	Lushnjë	42,700
26	Patos	30,000
27	Roskovec	37,000
6. Qarku Gjirokastrë		
28	Gjirokastrë	48,835
29	Këlcyrë	27,300
30	Libohovë	29,400
31	Memaliaj	21,800
32	Përmet	35,800
33	Tepelenë	27,400
7. Qarku Korçë		
34	Bilisht	36,200
35	Ersekë	26,800
36	Korçë	51,500
37	Leskovik	21,220
38	Maliq	29,747
39	Pogradec	49,230
8. Qarku Kukës		
40	B.Curri	29,100
41	Krumë	27,800
42	Kukës	41,000
9. Qarku Lezhë		
43	Laç	43,077
44	Lezhë	53,150
45	Mamurras	32,540
46	Rrëshen	40,605
47	Rubik	29,113
10. Qarku Shkodër		
48	Fushë-Arrëz	7,960
49	Koplik	40,730
50	Pukë	22,687
51	Shkodër	55,300
52	Vau Dejës	26,425
11. Qarku Tiranë		
53	Kamëz	51,000
54	Kavajë	58,575
55	Rrogozhinë	38,300
56	Vorë	50,000
57	Tiranë	88,200
12. Qarku Vlorë		
58	Delvinë	35,800
59	Himarë	53,500
60	Konispol	35,200
61	Orikum	57,000
62	Selenicë	25,300
63	Sarandë	52,096
64	Vlorë	60,298
1	Komuna Kërrabë	28,180
2	Komuna Shëngjin	49,720
3	Komuna Milot	34,786
4	Kashar	58,500
5	Dajt	57,800
6	Farkë	70,800



TABELA NR.3
TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE
NË QYTETIN E TIRANËS PËR VITIN 2011

Nr.	Zonat	Lekë/m ² , sipërfaqe shfrytëzimi
1	1/1	98,000
2	1/2	71,000
3	2/1	190,000
4	2/2	137,000
5	2/3	115,000
6	2/4	116,000
7	2/5	89,500
8	3/1	81,000
9	3/2	67,000
10	4/1	75,000
11	4/2	61,500
12	5/1	190,000
13	5/2	135,000
14	5/3	117,000
15	5/4	95,000
16	6	70,000
17	7/1	124,000
18	7/2	120,000
19	7/3	91,900
20	7/4	64,350
21	8/1	112,000
22	8/2	94,600
23	8/3	70,000
24	9/1	135,000
25	9/2	106,500
26	9/3	72,000
27	10/1	145,000
28	10/2	142,800
29	10/3	110,000
30	11/1	88,000
31	11/2	71,000
32	11/3	62,500

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 16.12.2011
Doli nga shtypi më 16.12.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 24 lekë